



REPUBLIKA E KOSOVES
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
 Dep. DPK
 Nr. I faq. _____
 Broj stranica _____
 Nr. pages 02

Nr. Prot. _____
 Br. Prot. 03-02/4465/16
 Prot No. _____
 Data _____
 Datum 29.11.2016
 Date _____

PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 29.11.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3387/16, për zyrtarin e lartë z. Osman Shahini, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Diasporës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mospajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-3387/16, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Osman Shahini, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Diasporës .

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit apo mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik është vërejtur se zyrtari i lartë z. Osman Shahini, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Diasporës, figuron si person i autorizuar në një biznes privatë e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese zyrtari i lartë z. Osman Shahini, ka ardhur ne zyrat e AKK-së, për tu njoftuar për situatën dhe nga zyrtarët e AKK-së, është njoftuar me çështjen e iniciuar për konflikt të interesit.

z. Shahini, gjatë këtij takimi është pajtuar me faktet e prezantuara dhe është deklaruar se biznesi ne fjalë për te cilin ka filluar procedura nuk zhvillon aktivitet por vetëm ka mbetur i regjistruar por ka theksuar se do ti ndërmarr te gjitha hapat dhe është zotuar se brenda afatit ligjor do te sjell dëshminë qe në biznesin e tij nuk do të ushtroj funksion menaxherial dhe do te heqë dorë nga personi i autorizuar ne këtë biznes.

Me datën 25.11.2016 nga zyrtari i lartë z. Osman Shahini, kemi pranuar dokumentin zyrtarë të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se ne biznesin me emër Qendra e Gjuhëve të Huja “De-En School” me nr.70506629 zyrtari i lartë z. Osman Shahini, tash më figuron vetëm si pronar, pasi qe ka emëruar si person të besuar të këtij biznesi një person tjetër.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Osman Shahini, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Diasporës, janë krijuar rrethana të reja dhe konsiderojmë se është shmangur gjendja e mundshme e konfliktit të interesit dhe mospajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Shqip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

